



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 02.06.2025, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2025-2026

Neni 1

Miratohet Vendimi për miratimin e Planit lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026.

Neni 2

Plani lokal i veprimit për barazi gjinore, i cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, është bazuar në Ligjin nr. 05/L-020 për barazi gjinore, Programin e Kosovës për barazi gjinore 2020-2024 dhe në Kartën evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale, për një periudhë (2) vjeçare, për vitet 2025-2026.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është kopja e Planit të veprimit për barazi gjinore, 2025-2026.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-011/01-79056/25, më 04.06.2025

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

